

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6740
E martë, 25 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Sunak, kryeministër i ri i Britanisë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RAPORTUESJA PËR KOSOVËN NË PARLAMENTIN EVROPIAN, VIOLA VON CRAMON, KA MBAJTUR TË HËNËN KONFERENCË PËR MEDIE NË PRISHTINË

VON CRAMON: VENDIMI PËR VIZAT, KAH FUNDI I VITIT



Raportuesja e Parlamentit Evropian, Viola von Cramon, në një konferencë për medie mbajtur në Prishtinë, ka paraqitur pikëpamjet e saj për situatën aktuale, posaçërisht në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave dhe diskutimet e fundit për këtë në Këshillin e BE-së si

dhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Ajo ka thënë se shpreson që të mos vendosen kushtëzime apo që procesi i liberalizimit të vizave të lidhet me ndonjë metodologji të re të Bashkimit Evropian. Sipas Cramonit, vendimi për vizat do të jetë kah mesi i nëntorit apo fillimi i dhjetorit

PAS SHUMË KRITIKAVE NGA OPOZITA, KUVENDI MIRATON STRATEGJINË E SIGURISË



IBRAHIMI PËR DIALOGUN: PËR
ÇËSHTJE TË INTERESIT KOMBËTAR
OPOZITA NUK MUND TË ABSTENOJË

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



MË 14 MAJ 2023 MBAHEN
ZGJEDHJET LOKALE NË SHQIPËRI

NË ANP 'ADEM JASHARI'
REALIZOHEN 17 FLUTURIME NË
SHIKUESHMËRI PREJ VETËM
100 METRASH

HOVENIERI KËRKON MË SHUMË
ANGAZHIM PËR LUFTIMIN E KRIMIT
TË ORGANIZUAR DHE DHUNË
SEKSUALE



EKONOMI

LUFTA NË UKRAINË PO THELLON
KRIZËN EKONOMIKE NË BALLKANIN
PERËNDIMOR

ATK-ja POZICIONOHET VEND LIDER
NË RAPORTIN E PEFA-S

SPORT



ENDRIT KRASNIQI, "YLLI I JAVËS"
NË SUPERLIGËN E KOSOVËS

Më 14 maj 2023 mbahen zgjedhjet lokale në Shqipëri

TIRANË, 24 TETOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, ka caktuar 14 majin 2023 datë të zhvillimit të zgjedhjeve lokale. "Sot caktova 14 majin 2023 datë të zhvillimit të zgjedhjeve të ardhshme vendore. E vlerësoj periudhën deri në zgjedhje si shumë të rëndësishme për përmbylljen me sukses të kësaj sfide demokracie për institucionet, partitë politike dhe gjithë shoqërinë shqiptare dhe theksoj se është koha për të demonstruar përkushtim dhe

bashkëpunim institucional, pjekuri politike dhe përgjegjshmëri qytetare", ka njoftuar Begaj.

Ai i ka ftuar të gjitha palët të shkojnë drejt kësaj date me përlësi dhe respekt ndaj qytetarëve dhe kundërshtarëve politikë. "Ftoj votuesit të mos anashkalojnë detyrën qytetare të mirinformimit mbi alternativat politike dhe ushtrimit të të drejtës së votës, të pandikuar nga interesa, që cenojnë votën dhe vullnetin e lirë. Komisioni i Reformës

Zgjedhore ka detyrimin ta përshpejtojë punën dhe t'i adresojë me kohë të gjitha çështjet e dala nga rekomandimet e raportit të OSBE/ODIHR-it. Vlerësoj nevojën e vendosjes së normalitetit politik në pushtetin vendor dhe u bëj thirrje partive politike që të shkojnë në këto zgjedhje me alternativa politike serioze e konkurruese, që kanë në qendër të vëmendjes qytetarin dhe standardet më të mira demokratike", ka njoftuar presidenti Begaj.



Sunak, kryeministër i ri i Britanisës



LONDËR, 24 TETOR - Rishi Sunak ka fituar garën në Partinë Konservatore të Britanisës, duke u bërë kryeministër i ri i vendit. Ai do të bëhet kryeministri i parë britanik me prejardhje indiane dhe do ta udhëheqë Britaninë, shtet që po përballet me sfida të mëdha ekonomike. Kundërkandidatja e tij, Penny Mordaunt, u tërhoq nga gara për të parën e partisë dhe udhëheqjen e qeverisë. "Këto janë kohë të paprecedentë. Kam marrë vendim për t'u tërhequr nga gara për të mirën e shtetit", ka

shkruar ajo në "Twitter". Sunak, 42 vjeç, u bë i njohur për publikun britanik gjatë kohës së qeverisjes së Boris Johnsonit, i cili e emëroi atë në postin e ministrit të Financave, në kohën kur Britania regjistroi rastet e para me koronavirus. "Kam shërbyer si kancelari juaj, duke ndihmuar që ta drejtojmë ekonominë tonë në kohët më të vështira", tha Sunak përmes një deklarate të dielën. "Sfidat me të cilat po përballemi tani janë edhe më të mëdha por mundësitë, nëse bëjmë zgjedhjen e duhur, janë

fenomenale", shtoi ai. Po ashtu, nga gara për kryeministër më 23 tetor u tërhoq edhe ish-kryeministri britanik Boris Johnson. Ai tha se po tërhiqej nga gara pavarësisht se kishte mbështetje të mjaftueshme në Partinë Konservatore për ta vazhduar garën, por tha në këtë kohë parti, por edhe shteti, kanë nevojë për unitet. Ai i ndërpreu pushimet në Karaibe për të tentuar që ta sigurojë mbështetjen e 100 ligjvënësve në mënyrë që të hynte në garë të

hënën për ta zëvendësuar Liz Truss.

Truss pasoi Johnsonin në postin e kryeministrit, pasi ky i fundit dha dorëheqje në shtator për shkak të një sërë skandalesh etike. Johnsoni tha se siguroi mbështetjen e 102 ligjvënësve që do të mund t'i siguronin kthimin në Zyrën e kryeministrit, por dështoi që ta bindte Sunakun apo edhe kandidaten tjetër, Penny Mordaunt, që të bashkohen "për interesin kombëtar". "Besoj se mund të ofroj shumë, por jam i frikësuar se thjesht tani nuk është

koha e duhur", tha Johnsoni në orët e vona të së dielës.

Sunak do ta zëvendësojë Trussin, e cila u detyrua të japë dorëheqje pasi lansoi një program ekonomik që shkaktoi trazira në tregjet financiare.

Truss dha dorëheqje më 20 tetor, 44 ditë pasi u zgjodh në postin e kryeministres.

Sipas rregullave partiake, kandidati fitues duhet ta sigurojë mbështetjen e 100 ligjvënësve konservatorë. Pas tërheqjes nga gara, Mordaunt ofroi mbështetjen e saj për Sunakun.

OBSH-ja: "Nuk është koha për relaksim" nga koronavirusi dhe gripi stinor

GENEVË, 24 TETOR - Organizata Botërore e Shëndetësisë ka bërë thirrje për vigjilencë tek sa po rritet numri i rasteve me koronavirus dhe grip stinor në Evropë. "Kjo nuk është kohë për relaksim", ka thënë drejtori i OBSH-së për Evropë, Hans Kluge, në një konferencë për medie, duke iu referuar afrimit të stinës së dimrit. Të 53 shtetet që përfshin OBSH-

ja në Evropë, përfshirë Rusinë dhe Azinë Qendrore, janë sërish epiqendër e pandemisë së koronavirusit, pasi në to janë regjistruar 60 për qind të rasteve në nivel global, ka thënë Kluge.

Në të njëjtën kohë, rastet me grup stinor janë duke iu afruar pikut.

Në këtë valë të re të koronavirusit nuk është duke u

rritur numri i vdekjeve apo edhe i shtrimit të pacientëve në kujdes intensiv, prandaj OBSH-ja e ka përmendur rëndësinë e vaksinimit. "Vaksinimi mbetet një prej mënyrave tona më efikase kundër grupit stinor dhe koronavirusit", ka thënë Kluge, duke u bërë thirrje njerëzve t'i marrin dozat përforcuese sa më shpejt që është e mundur.



Avancohet Kosova në rrugën e integrimit në BE përmes arsimit

“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 TETOR - Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Kosovës kanë lansuar të hënën raundin e 13-të të Programit të Bursave për Master të BE-së i cili synon ta përmirësojë punën e administratës publike dhe shërbimet që ajo ofron për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë duke ofruar arsim të lartë për nëpunësit e tanishëm dhe të ardhshëm civil.

Programi i njohur si Young Cell Scheme po ndihmon në harmonizimin e funksionimit të administratës publike të Kosovës me standardet e BE-së, duke ndihmuar kështu Kosovën të përparojë në rrugën e saj të integrimit në BE. “BE-ja fillimisht filloi ta mbështesë arsimin e nivelit master të shërbyesve civilë në Kosovë në vitin 2004. Që atëherë, 364 nëpunës civilë u arsimuan në fushat që i konsideronte më të nevojshme qeveria dhe u kontribua shumë në punën e administratës publike në Kosovë dhe në cilësinë e shërbimeve që ofron. Me fillimin e raundit të 13-të të Programit të Bursave për Master të BE-së, i cili do të përfshijë së paku

40 studentë të rinj dhe nëpunës civilë, ne po vazhdojmë ta mbështesim Kosovën në përmirësimin e administratës së saj publike dhe në aspektin për ta bërë atë jopolitike dhe më profesionale, transparente dhe të përgjegjshme”, ka thënë ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog.

Ai ka inkurajuar fuqishëm pjesëmarrjen e grave dhe komuniteteve joshumicë në këtë program.

Investimi i BE-së në 12 të parat dhe tre raundet e reja të Programit të Bursave Master do të arrijë në 15.3 milionë euro.

Qeveria e Kosovës ka filluar bashkëfinancimin e programit që nga raundi i 11-të dhe me zotimin për tre raundet e ardhshme do të ketë investime 2.5 milionë euro në arsimimin e nëpunësve civilë në universitetet e BE-së.

Deri në vitin 2026 të paktën 470 persona nga Kosova duhet të përfitojnë nga programi. “Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar për avancimin e mëtejshëm të procesit të reformave të administratës publike, duke e shfrytëzuar projektin si një nga mundësitë më të mira që siguron dhe promovon transparencën dhe meritokracinë në shërbimin civil. Këtë projekt e



konsiderojmë unik, sepse mundëson arritjen e njëkohshme të disa qëllimeve”, ka thënë zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi. Ai ka shtuar se ky është investimi më i qëndrueshëm në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim. “Ndryshe nga shumë projekte të

tjera që kanë në fokus asistencën nga ekspertiza e jashtme, mundëson fuqizimin e agentëve lokalë të ndryshimit brenda vendit dhe, për më tepër, brenda sistemit qeverisës”, ka deklaruar Bislimi. Programi i Bursave për Master i BE-së i obligon përfituesit e tij që të punojnë në një nga institucionet e

Kosovës për të paktën tre vjet pas diplomimit.

Tre raundet e ardhshme të programit do të zbatohen nga Universiteti Aristoteles i Selanikut nga Greqia dhe Instituti Kombëtar i Shërbimit Publik nga Franca në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë e Kosovës.

Ibrahimi për dialogun: Për çështje të interesit kombëtar opozita nuk mund të abstenojë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 TETOR - Vetëm kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, i është përgjigjur pozitivisht ftesës së kryeministrit Albin Kurti për të diskutuar për procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ky takim që ka ndodhur javën e kaluar është mbajtur në zyrën e kryeministrit, ndërsa Haradinaj para medieve ka bërë me dije se me Kurtin ka diskutuar për përmbajtjen e marrëveshjes potenciale me Serbinë. Haradinaj ka thënë se marrëveshja finale duhet ta ketë vulën e ShBA-së. “Diskutuaam për procesin, diskutuaam për marrëveshjen, për sfidat që i ka Kosova në këtë proces. Mund të them se ishte takim me përmbajtje, sepse kemi diskutuar për përmbajtjen e një marrëveshjeje potenciale Kosovë - Serbi”, ka thënë Haradinaj.

Më tutje, Haradinaj ka thënë se finalizimi i këtij procesi duhet të bëhet me vulën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe se marrëveshja do të duhej të nënshkruhej në Uashington. “Duhet ta ketë vulën e Amerikës, jo vetëm mbështetjen e Amerikës. Për të qenë ky proces në garanci të plota, duhet të

nënshkruhet edhe nga niveli i njëjtë amerikan”, ka theksuar Haradinaj, duke bërë thirrje për qasje serioze në këtë fazë të dialogut. “Vendimet e dialogut nuk janë vendime që i ndryshon dikush më pas. Duhet të jemi sa më seriozë, duke marrë parasysh shkallën e seriozitetit të aktorit ndërkombëtar, duke parë sa seriozë janë Uashingtoni, Berlioni, Londra, Parisi. Ne duhet ta konsiderojmë me shumë seriozitet këtë proces. Do të punojmë që Kosova të dalë e suksesshme. Nuk bëhet fjalë për agjenda të tjera, as zgjedhore, as qeverisëse”, është shprehur Haradinaj.

Ndërsa zyra e kryeministrit ka njoftuar se Kurti e ka falënderuar Haradinajn për interesimin e vazhdueshëm në raport me dialogun.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kanë refuzuar ftesën e Kurtit, duke theksuar se për këtë temë flasin vetëm në Kuvendin e Kosovës dhe se Lëvizja Vetëvendosje ka fituar shumicën për të marrë vendime. Analisti politik Ilir Ibrahimi ka theksuar se qëndrimi i opozitës, por edhe i shumë të tjerëve, se kryeministri e gëzon mandatin për vendimmarrje, sepse ka fituar shumicën, në aspektin formal juridik qëndron. Por, sipas tij,



nëse kemi të bëjmë me çështje të interesit kombëtar, nuk mund të abstenosh. “Është e vërtetë, më 14 shkurt partia në pushtet fitoi një shumicë bindëse si rezultat i një disponimi momental - madje që natën e zgjedhjeve e kam quajtur fitore aksidentale, dhe vazhdoj ta shpreh këtë qëndrim. Por kjo fitore nuk ia ka dhënë kësaj partie të drejtën të vendosë

për fatin e vendit për dekadat e ardhshme. Prandaj, jo vetëm partitë opozitare, por edhe elita intelektuale dhe udhëheqëse e vendit e kanë obligim që të ketë qëndrim dhe të marrë pjesë aktive kur jemi dëshmitarë se në javët e muajt në vazhdim vendoset fati edhe i disa gjeneratave të ardhshme”, ka shkruar Ibrahimi në “Facebook”.

Ai ka shtuar se shembulli më i mirë është përfaqësimi i Kosovës në Rambuje.

“Rugova si një lider me një votë të fuqishme (edhe pse vota ishte dhënë në rrethana të okupimit) pati mençurinë dhe urtësinë për të ndërtuar konsensus, madje duke e dhënë udhëheqjen e përfaqësimit të një person tjetër”, ka shkruar Ibrahimi.



RAPORTUESJA PËR KOSOVËN NË PARLAMENTIN EVROPIAN, VIOLA VON CRAMON,
KA MBAJTUR TË HËNËN KONFERENCË PËR MEDIE NË PRISHTINË

Von Cramon: Vendimi për vizat, kah fundi i vitit

Raportuesja e Parlamentit Evropian, Viola von Cramon, në një konferencë për medie mbajtur në Prishtinë, ka paraqitur pikëpamjet e saj për situatën aktuale, posaçërisht në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave dhe diskutimet e fundit për këtë në Këshillin e BE-së si dhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Ajo ka thënë se shpreson që të mos vendosen kushtëzime apo që procesi i liberalizimit të vizave të lidhet me ndonjë metodologji të re të Bashkimit Evropian. Sipas Cramonit, vendimi për vizat do të jetë kah mesi i nëntorit apo fillimi i dhjetorit.

**EPOKA
ERE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 24 TETOR - Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, ka thënë se një vendim për liberalizimin e viza për Kosovën pritet të merret kah mesi i nëntorit apo fillimi i dhjetorit, duke theksuar se shpreson që ky vendim të jetë pozitiv. Në një konferencë për medie në Prishtinë të hënën, Von Cramon ka thënë se shpreson që të mos vendosen kushtëzime apo që procesi i liberalizimit të vizave të lidhet me ndonjë metodologji të re të Bashkimit Evropian. "Vendimi do të jetë dikur kah mesi i nëntorit apo fillimi i dhjetorit. Por, pyetja është se a do të çojë te një sistem i ri i kushteve për vizat, që do të ishte krejtësisht i padrejtë, apo përfundimisht do të shohim një datë për vizat", ka theksuar ajo.

Gjatë mbledhjes së një grupi punues të vizave në Këshillin e BE-së, të mbajtur më 13 tetor, zyrtarët francezë raportohet se kanë kërkuar që procesi i vizave për Kosovën të lidhet me funksionalizimin e sistemit për siguri në Evropë, ETIAS. ETIAS është sistem evropian për autorizim dhe informacione rreth udhëtimit. Ky sistem elektronik mundëson verifikimin e të dhënave të qytetarëve të vendeve të treta që nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në Zonën Shengen. Procedura ligjore për ta miratuar këtë sistem ka nisur më 2016 dhe sistemi pritet të jetë plotësisht operacional brenda vitit 2023, pa ndonjë datë të saktë. Von Cramon ka thënë se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për vizat dhe vendimi për këtë çështje është i vonuar, por shtoi se vonesat janë "të padrejta" për

shtetasit e Kosovës, që janë të vetmit në rajon që nuk mund të udhëtojnë pa viza në Zonën Shengen. Ndërkaq presidentja e vendit, Vjosa Osmani, në vazhden e takimeve me ambasadorë evropianë ditët e fundit, ka ritheksuar se Kosova është vendi më proevropian dhe se populli i saj i ndan të njëjtat vlera me popujt e tjerë evropianë. Në këtë kontekst, ka potencuar se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret për liberalizim vizash ndaj, sipas saj, duhet zbatuar rekomandimi i Komisionit Evropian për heqjen e vizave. Sipas presidentes Osmani, liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës nuk duhet të mbetet peng i teknikaliteteve të reja dhe se vendimarrja politike duhet të ndodhë gjatë Presidencës Çeke, ndërkaq hyrja në fuqi sipas praktikave paraprake. Në të njëjtën kohë,

Osmani diskutoi me ambasadorët rëndësinë e mbështetjes për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës me të cilën gjë qytetarëve të Kosovës u mundësohet fuqizimi i të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimin e ligjit.

E partitë opozitare kanë kërkuar angazhim të Kuvendit për liberalizimin e vizave.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në një nga mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, ka kërkuar që ky institucion t'i adresohet Presidencës Çeke dhe të gjithë kryeparlamentarëve të vendeve anëtare, me një kërkesë që lidhet me një mosvendim për liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. "AAK-ja vlerëson se ky është një diskriminim klasik dhe është një zvarritje e cila nuk duhet të ndodhë", ka thënë Tahiri.

Ai ka shtuar se çfarëdo sistemi që BE-ja e aplikon për vendet e tjera joanëtare të Shengenit, mund të hyjë në fuqi edhe për Kosovën pasi që të liberalizohen vizat. "Pra, heshtja e Kuvendit nuk është e drejtë dhe për këtë arsye e ngrita këtë çështje te Kryesia e Kuvendit që të ketë një adresim serioz", është shprehur Tahiri.

Propozimi franko-gjerman, mundësi e mirë

Raportuesja për Kosovën në PE foli edhe për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë. Von Cramon ka thënë se Kosova duhet të përkrahë një propozim të Francës dhe Gjermanisë, që thuhet se ka për synim ta shtyjë përpara Prishtinën në rrugën evropiane. "Unë dua të komentoj për nismën e re franko-gjermane. Po shihet se ka përparim të ri. Është një frymë e re në gjithë procesin. Po e shohim se në të dyja anët, si në Beograd ashtu edhe në Prishtinë, njerëzit e kanë kuptuar se është koha, është momenti që të arrijmë, nëse jo një marrëveshje përfundimtare, të paktën një pako që do të ishte e pranueshme për të dyja palët", ka deklaruar ajo.

Sipas saj, edhe nëse kjo marrëveshje nuk parasheh 100 për qind kërkesat e Kosovës në dialog, është më mirë që të fitohet "90 për qind" tani dhe shteti të ecë përpara, por shtoi se ky është rekomandimi i saj dhe se u mbetet liderëve në Kosovë të vendosin për këtë çështje. "Shumë njerëz kanë shkruar për këtë propozim franko-gjerman, që është një mundësi e madhe, dhe unë do t'i kërkoja secilit që

Von der Leyen viziton Ballkanin Perëndimor



© Jean-Francois Badias/AP Photo/picture alliance

PRISHTINË, 24 TETOR - Bashkimi Evropian ka përsëritur se lidhjet me vendet e Ballkanit Perëndimor i sheh me një rëndësi të veçantë dhe ka ritheksuar gatishmërinë që ato lidhje të forcohen. Në të njëjtën kohë, BE-ja është shprehur e gatshme t'i përfshijë edhe vendet e këtij rajoni në disa politika të saj, përfshirë edhe në planet për sigurimin e burimeve të reja të furnizimit me energji elektrike, gaz dhe naftë, në kohën kur BE-ja po ndërmer masa për ta zvogëluar ndikimin nga Rusia.

Për këto, si dhe për temat e tjera, pritet të diskutohet në takimet që liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor do të kenë me presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e cila këtë javë do të nisë një turne katërditësh nëpër gjashtë vendet e këtij rajoni.

Vizitat në vendet e Ballkanit Perëndimor presidentja e Komisionit Evropian, Von der Leyen, do t'i nisë në Shkup të mërkurën. Prej atje të enjten do të vizitojë Kosovën, prej nga të njëjtën ditë do të vazhdojë për në Tiranë.

Von der Leyen do ta vazhdojë turneun në Sarajevë më 28 tetor dhe në Beograd. Këtë turne nëpër gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor presidentja e Komisionit Evropian do ta përmbyllë me vizitë në Mal të Zi të shtunën më 29 tetor.

Von der Leyen në rajon do të diskutojë me bashkëbiseduesit e saj edhe për bashkëpunimin rajonal, reformat evropiane, gjetjet e raporteve të fundit të progresit dhe për sfidat e përbashkëta, siç janë edhe menaxhimi i migracionit dhe përballja me rritjen e çmimeve të energjisë dhe ushqimit. Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës dhe pasojat që ka, si për rajonin e Ballkanit, ashtu edhe për tërë Evropën, do të jenë, po ashtu, temat që priten të diskutohen.

Në Bruksel thonë se tashmë është evidente se ka ardhur deri tek shtimi i kontakteve në nivele më të larta mes BE-së dhe vendeve të

Ballkanit Perëndimor dhe kjo do të vazhdojë. Janë zhvilluar disa takime në nivel të ministrave edhe në kuadër të Procesit të Berlinit, ku merr pjesë edhe BE-ja.

Ndërkaq në javën e parë të nëntorit pritet të zhvillohet edhe Samiti i Procesit të Berlinit. Më pas, më 6 dhjetor, pritet të zhvillohet edhe një samit i veçantë i liderëve të BE-së dhe vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka konfirmuar se samiti do të zhvillohet më 6 dhjetor, por në Tiranë e jo në Bruksel apo Pragë. "Ne do ta zhvillojmë samitin e ardhshëm BE-Ballkani Perëndimor në rajon. Më 6 dhjetor në Tiranë, në Shqipëri, për ta rikonfirmuar angazhimin tonë të përforcuar" ka shkruar Michel në rrjetet sociale. Ai është shprehur se Ballkani Perëndimor është prioritet kyç për Bashkimin Evropian dhe se BE-ja dhe këto vende "kanë nevojë për njëra-tjetrën".

Samiti i fundit i Ballkanit

Perëndimor ishte zhvilluar në Bruksel në fund të qershorit të këtij viti kur kryesimin e radhës me BE-në e kishte Franca. Takimi kishte kaluar në një atmosferë jo edhe aq pozitive, sepse ishin dëgjuar shumë kritika drejtuar BE-së për dështime ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në atë kohë Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria ishin të bllokuara në procesin e integritetit dhe nuk mund t'i nisnin negociatat e anëtarësimit. Nuk kishte lëvizje as në procesin e liberalizimit të vizave me Kosovën.

Burimet në Bruksel thonë se ndërkohë kanë ndodhur ndryshime pozitive që japin shpresë se procesi i zgjerimit po hyn në një fazë të re. Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria tashmë kanë hapur negociatat e anëtarësimit, që nga Komisioni Evropian është quajtur si "kthesë historike në procesin e zgjerimit".

Para dy javësh Komisioni Evropian ka rekomanduar me kusht që Bosnjë-Hercegovinës t'i

jepet statusi i vendit kandidat. Ky vendim, nëse Bosnja-Hercegovina përmbush disa kushte, mund të miratohet edhe në muajin dhjetor.

Edhe procesi i liberalizimit të vizave me Kosovën ka lëvizur nga vendi dhe është zhvilluar diskutimi i parë në grupin punues të këshillit për vizat. Me përjashtim të Serbisë, të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor i kanë mbështetur sanksionet e BE-së ndaj Rusisë.

Të gjitha këto nga zyrtarët e BE-së në Bruksel shihen si dëshmi se në muajt e fundit ka pasur lëvizje pozitive në raportet e BE-së me Ballkanin Perëndimor dhe kjo do të konfirmohet në një samit të përbashkët në kryeqytetin e Shqipërisë.

Edhe në këtë samit do të marrë pjesë presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe përgatitjet për atë takim mund të jenë ndër temat që ajo do t'i diskutojë gjatë qëndrimit të saj këtë javë në vendet e rajonit.

është në pushtet dhe që të mund të marrë vendime, t'i shqyrtojnë me kujdes këto propozime. Mendoj se ky është rast i mrekullueshëm që të dyja palët të ecin përpara drejt integritetit evropian, që mendoj se është absolutisht i nevojshëm. Kosova si vendi më pro-evropian duhet ta përkrahë këtë", ka pohuar Von Cramon.

Franca dhe Gjermania është raportuar se u kanë ofruar një propozim liderëve të Kosovës dhe Serbisë për shtyrjen përpara të procesit të dialogut.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se ky propozim konsiston në atë që shteti i tij të mos pengojë anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, përfshirë edhe

në Kombet e Bashkuara, në këmbim të një anëtarësimi të shpejtë të Serbisë në BE.

Edhe i dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka shprehur mbështetjen për këtë nismë, duke thënë se do ta zhbllokonte rrugën e Kosovës dhe Serbisë drejt integriteteve euroatlantike.

Kosova dhe Serbia kanë nisur procesin e dialogut për normalizimin e raporteve më 2011 me ndërmjetësimin e BE-së. Prishtina kërkon që ky proces të përfundojë me një marrëveshje që do ta përfshinte njohjen reciproke, por Serbia kërkon një zgjidhje kompromisi, pa treguar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.



Në ANP 'Adem Jashari' realizohen 17 fluturime në shikueshmëri prej vetëm 100 metrash

PRISHTINË, 24 TETOR - Më 21 tetor Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës 'Adem Jashari' ka realizuar 17 fluturime me shikueshmëri prej vetëm 100 metrash. Kjo është hera e parë që të gjitha fluturimet ishin në kohë në mbërritje dhe nisje në këtë nivel të shikueshmërisë së ulët.

Projekti i zgjatjes së pistës për 3040 m dhe përmirësimi në ILS CAT IIIB ka rezultuar në pavonesë të fluturimeve, pa ndalim në ajër dhe pa devijim drejt aeroporteve të tjera. Ky është një nga projektet me rëndësi vendimtare për aeroportin duke theksuar se siguria dhe kënaqësia e pasagjerëve janë prioritetet kryesore të aeroportit. ANP 'Adem Jashari' njihet për vonesa në fluturime për shkak të mjegullës në stinën e dimrit ku shumë fluturime janë devijuar dhe kanë funksionuar me vonesa të mëdha në të kaluarën. Projekti i ri i pistës



përfundoi në vitin 2021 duke u shtrirë nga 2500 m në 3040 m. Sistemi ILS është përmirësuar në CAT IIIB. Sistemi CAT IIIB ndihmon me një afrim dhe ulje precize kur dukshmëria e pistës është në një distancë jo më pak se 50 feet (15 m) dhe është në një distancë vizuale më pak se 200 metra dhe sigurisht jo më pak se 50 metra. Sistemet meteorologjike dhe AWOS (Automated Weather Observing System) janë zëvendësuar me të reja dhe janë instaluar antena të reja për ta lehtësuar menaxhimin e hapësirës ajrore. U realizuan harta të reja për hapësirën ajrore dhe u instalua sistemi më i lartë i parashikimit të meteo-ve. Vlen të theksohet se pajisjet janë të teknologjisë më të fundit të blera nga Kanadaja, Gjermania, Holanda, Finlanda dhe Norvegjia.

Në hapësirat publike të Liqenit Akumulues mbillen edhe 27 fidanë

MITROVICË, 24 TETOR - Drejtorja për Mbrojtje të Mjedisit në Mitrovicë është përkujdesur që përgjatë Liqenit Akumulues të mbjellë edhe 27 fidanë, donacion nga kompania "Twig". Këta fidanë janë mbjellë nga drejtori për Mbrojtje të Mjedisit, Egzon Sadiku, së bashku me përfaqësuesit e kësaj kompanie dhe disa ambientalistë të

Mitrovicës. Me këtë rast, drejtori Sadiku ka falënderuar përfaqësuesit e kompanisë "Twig" për dhurimin e këtij donacioni mjaft të nevojshëm, duke thënë se prioritet i drejtorisë të cilën e udhëheq ai është shtimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe krijimi i një mjedisi sa më të pastër në tërë qytetin.



Fillon ndërtimi i Qendrës për Trajtimin e Kafshëve në Prishtinë



PRISHTINË, 24 TETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se ka filluar ndërtimi i Qendrës për Trajtimin e Kafshëve. "Për herë të parë në Kosovë ndërtohet një qendër e tillë, e cila kryesisht fokusin do ta ketë në trajtimin e qenve endacakë. Kryeqyteti është zotuar ta zgjidhë këtë çështje, e cila kërkon bashkëpunim të ngushtë mes të gjitha komunave, veçanërisht me institucionet qendrore. Siguria e qytetarëve tanë është prioritet", ka thënë kryetari Rama.

Kryetari i Gjilanit viziton punimet infrastrukturore

GJILAN, 24 TETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka vizituar punimet infrastrukturore në Lagjen e Vishnjeve dhe në Llashticë. Kryetari Hyseni ka thënë se ekipi i palodhshëm i punëtorëve po kujdeset për infrastrukturën në çdo lagje e fshat të komunës. "Lagja e Vishnjeve, një tjetër lagje në të cilën po ndërtohet dhe asfaltohet rruga e po bëhet shtrirja e rrjetit të kanalizimit. Llashtica, fshat tjetër në të cilin po punohet për një infrastrukturë më të mirë e jetë më cilësore për banorët", ka theksuar ai.



Shpërndahen mjete dhe vegla pune të ndërtimtarisë për pjesëtarin e komunitetit pakicë në Podujevë

Podujevë, 24 tetor - Në kuadër të Programit për Stabilizimin e Komuniteteve joshumicë në komunën e Podujevës, Hajriz Bajrami, pjesëtar i komunitetit ashkali, është përfitues i projektit me mjete dhe vegla pune të ndërtimtarisë në vlerë prej 4 300.00 eurosh. Të pranishëm në shpërndarjen e mjeteve ishin përfaqësuesit e Zyrës

për Komunitete dhe Kthim në komunën e Podujevës, Liman Zeqiri dhe Xhevdet Beqiri, si dhe nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Igballe Ymeri. Shefi i ZKKK-së, Liman Zeqiri, u shpreh shumë i kënaqur për realizimin e projektit dhe tha: "Komuna e Podujevës është e gatshme t'i përkrahë projektet që kanë

për qëllim përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve nga komunitetet pakicë dhe projektet të cilat synojnë integrimin e komuniteteve në jetën institucionale e shoqërore në komunën e Podujevës". Projekti u mbështet në shumën prej 4 000.00 eurosh nga IOM-i, ndërsa 300 euro nga përfituesi.



Hovenieri kërkon më shumë angazhim për luftimin e krimit të organizuar dhe dhunës seksuale

PRISHTINË, 24 TETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Jeffrey Hovenier, në konferencën për Javën për të drejtat e viktimave të krimit, ka thënë se sistemi i drejtësisë në Kosovë mund të bëjë më shumë për trajtimin efikas të viktimave të krimit, me theks të veçantë për viktimat e dhunës në familje, dhunës seksuale dhe viktimat e trafikimit të njerëzve.

Hovenieri ka theksuar se institucionet relevante të drejtësisë ekzistojnë për të siguruar se ka drejtësi dhe se kjo javë jo vetëm që rritë ndërgjegjësimin për viktimat e krimit, por rritë edhe reflektimin mbi përpjekjet e institucioneve që të ndërmarrin veprime që të gjitha viktimat t'i marrin shërbimet e duhura, duke shtuar se shumë shpesh shfaqen pabarazi dhe abuzime të shumëfishta, pikërisht ndaj këtyre grupeve. "Fillimisht ne duhet të jemi në gjendje t'i dëgjojmë këto viktimat, sepse këta pjesëtarë janë caqë të cenimit të krimeve, trafikimit dhe, shpesh

nuk jemi të përgatitur t'i dëgjojmë këta persona. Pa i dëgjuar nuk mund t'i ndihmojmë", ka thënë Hovenier. Ambasadori theksoi se ka shumë gjëra për të cilat institucionet e Kosovës mund të lavdërohen për garantimin e të drejtave të viktimave të krimit, pasi kjo është kodifikuar edhe me Kodin e ri të Procedurës Penale të Kosovës, duke shtuar se kjo tregon përkushtimin e institucioneve. Ai ka thënë se sidomos trajnimi i prokurorëve në fushën e dhunës në familje, rastet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe rastet e dhunës në familje, është praktika më e mirë për shumë arsye, pasi kemi prokurorë me ekspertizë të specializuar për sfidat që paraqiten në drejtësi për këto viktimat. "Ne i mbështesim të gjitha këto përpjekje si dhe të gjitha aktivitetet e organizuara gjatë kësaj jave", ka thënë ambasadori Hovenier.

Ai ka deklaruar se sistemi i drejtësisë mund të bëjë edhe më shumë për viktimat e krimit. "Unë nuk po e përfaqësoj sistemin amerikan të drejtësisë si



të përsosur, sepse edhe ne kemi probleme, por duhet të përkushtohemi për t'u dhënë zë atyre që nuk kanë zë, e që janë bërë viktimat të veprimeve kriminale të dikujt tjetër", ka shtuar Hovenier.

I njëjti shtoi se është shumë e rëndësishme që kriminelët të mbahen përgjegjës, personat që kanë shkaktuar dhunë në familje, dhunë seksuale apo trafikim. "U kërkojmë institucioneve të zbatimit të ligjit që të

bashkëpunojnë dhe t'u japin përparësi ndjekjeve penale të dhunës në familjes dhe dhunës në bazë gjinore, sepse këtu mund të aplikohen fillimisht mjete për vlerësimin e rrezikut", ka shtuar Hovenier.

Pas shumë kritikave nga opozita, Kuvendi miraton Strategjinë e Sigurisë

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 TETOR - Kuvendi i Kosovës ka arritur ta miratojë Strategjinë e Sigurisë së Kosovës për vitin 2022-2027. Nga 84 deputetë të pranishëm, vetëm 61 deputetë morën pjesë në votim, ku 60 vota ishin për dhe 1 abstenim.

Përfaqësuesit e qeverisë kanë theksuar se kjo strategji është hartuar në konsultim të ngushtë me të gjitha institucionet shtetërore. Sipas tyre, i është nënshtruar procesit të konsultimit të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë edhe përfaqësuesit e shteteve të Quintit dhe akademinë.

Ndërkaq përfaqësuesit e opozitës kanë drejtuar kritika për këtë strategji. Sipas tyre, ky dokument, që është kryesor për Republikën e Kosovës në fushën e sigurisë, nuk paraqet në mënyrë të qartë vizionin dhe orientimin e Kosovës për ruajtjen dhe kultivimin e sigurisë dhe paqes në vend.

Kryeministri Albin Kurti gjatë fjalës së tij në Kuvend ka bërë me dije se Strategjia e Sigurisë së Kosovës u jep drejtim institucioneve tona në përpjekje për unifikimin e politikave dhe qëndrimeve të cilat ndërliken me interesat shtetërore të sigurisë e për të ndërtuar një të ardhme të sigurt në paqe.

Kurti ka theksuar se synimi strategjik i Kosovës është anëtarësimi në NATO dhe në BE si

parakushte për sigurinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, por edhe të rajonit. Ai ka thënë se qeveria nën drejtimin e tij ka rritur për 52 për qind buxhetin për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK). "Gjatë qeverisjes sonë u kemi dhënë vëmendje të veçantë institucioneve të sigurisë me politika të qarta dhe veprime konkrete karshi tyre. E kemi rritur për 52 për qind buxhetin për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Buxhetit të FSK-së po i shtohen edhe mjete në Fondin e Sigurisë. Kemi përshpejtuar blerjet ushtarake dhe blerjet e tjera që lidhen me fuqizimin e kapaciteteve tona të mbrojtjes dhe sigurisë. Kemi krijuar linja të reja të furnizimit me sisteme të armatimit. Kemi themeluar një grup punues me qëllim të shtimit të punës për anëtarësim në NATO. Kemi krijuar mekanizma të rinj për më shumë koordinim të punëve në mes të institucioneve të sigurisë. Miratimi i Strategjisë së Sigurisë së Kosovës u jep drejtim institucioneve tona në përpjekje për unifikimin e politikave dhe qëndrimeve të cilat ndërliken me interesat shtetërore të sigurisë e për të ndërtuar një të ardhme të sigurt në paqe", ka deklaruar Kurti.

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteljencë, Ganimete Musliu, e ka kritikuar qeverinë për mënyrën e hartimit të dokumentit të



Strategjisë së Sigurisë së Kosovës 2022-2027. "Në fakt, kjo, para se të jetë strategji, mund të jetë analizë pa sintezë. Analiza pa sintezën e saj mbrapa është e mangët, e dobët dhe joefektive. Aq më tepër kur bëhet fjalë për një dokument strategjik i cili ka ardhur në Kuvend në rrethana të reja të sigurisë jo vetëm kombëtare, por edhe asaj rajonale dhe më gjerë. Gjuha deskriptive e përdorur në këtë

dokument tregon shterpësinë e artikullimit të qartë të sfidave dhe nevojave të Kosovës në fushën e sigurisë, por edhe mungesën e hapave konkretë që shteti i Kosovës do të duhej t'i kishte parasysh në rrethana të caktuara alternative", ka thënë deputetja Musliu.

Kurse deputeti i LDK-së, Anton Quni, ka thënë se Strategjia e Sigurisë së Kosovës për vitin 2022-

2027 është bërë në formatin "copy-paste". "E kam kuptuar që me hartimin e strategjisë është marrë vetëm një njeri, një person, i cili, nën presionin e kohës dhe përvojës së vogël për punë ekipore, e ka kompletuar dokumentin duke bërë 'copy-paste' të paragrafëve të strategjive të shteteve të Ballkanit. Po më vjen inati ta them këtë", ka thënë deputeti Quni.

Lufta në Ukrainë po thellon krizën ekonomike në Ballkanin Perëndimor

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 TETOR - Performanca ekonomike e gjashtë ekonomive të Ballkanit Perëndimor mbetet e prekur nga vazhdimi i luftës në Ukrainë dhe rritja e lartë e çmimeve të energjisë që ka rezultuar prej saj si dhe nga ngadalësimi i rritjes globale, pohon edicioni i fundit i Raportit të Rregullt Ekonomik për Ballkanin Perëndimor (numri 22 i serisë). Këto kriza po kthehen në pengesa për rajonin, përkundër rritjes më të lartë seç pritej më herët këtë vit.

Falë nxitjes prej konsumit dhe investimeve private, gjysma e parë e vitit 2022 u shoqërua me rritje solide ekonomike që i tejkaloi pritjet.

Në mesin e vitit 2022 nivelet e punësimit kapën pikat më të larta historike në disa prej vendeve të rajonit, ndërsa shkalla mesatare e punësimit në rajon tanimë është 46 për qind, duke u rritur për 3 pikë përqindjeje krahasuar me mesin e vitit 2021. Të gjithë sektorët kontribuan në

rimëkëmbjen e tregut të punës, por ishin shërbimet (përfshirë turizmin) që luajtën rol madhor. Sidoqoftë, vrulli i rritjes veçse ka filluar të ngadalësohet përballë sfidave në rritje. Çmimet e larta të energjisë dhe ushqimeve e kanë shtyrë inflacionin në nivele që nuk janë parë prej shumë vitesh, duke e dobësuar fuqinë blerëse dhe besimin e bizneseve. Aktiviteti në tregun e punës po fillon të ulet teksa shihet ngadalësim i ritmit të punësimit përballë inflacionit të lartë dhe rritjes së pasigurisë.

Edhe pse gjatë vitit 2022 vazhduan trendet rënëse të shkallëve të varfërisë, inflacioni shumë i lartë paraqet rreziqe për uljen e varfërisë në të ardhmen. Po të mos ishte mbështetja prej qeverive, ashpërsia e tronditjes së shkaktuar prej çmimeve të energjisë dhe ushqimeve mund të rezultonte me rritje për 13 për qind në numrin e qytetarëve të varfër në Ballkanin Perëndimor. "Qeveritë e Ballkanit Perëndimor po i marrin masat e nevojshme si kundërpërgjigje ndaj rritjes së inflacionit dhe

krizës energjetike, por çmimi që po paguhet është i lartë: shpenzimet publike janë rritur ndjeshëm", ka theksuar Xiaoqing Yu, drejtoreshë e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor. Sipas saj, është me rëndësi kritike që këto masa t'i zbusin ndikimet e krizave tek amvisëritë dhe bizneset më të cenuara. "Banka Botërore është e gatshme t'i mbështesë vendet në këto përpjekje", ka theksuar Yu.

Presionet e shpenzimeve fiskale, pas goditjeve të shkaktuara nga rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimit, e kanë amortizuar rritjen e të ardhurave publike që solli inflacioni i lartë si dhe e kanë ndaluar konsolidimin fiskal. Borxhi publik dhe ai i garantuar publikisht pritet të ulet gjatë vitit 2022, por sërish do të mbetet mbi nivelin kulmor të arritur para Covidit, ndërkohë që kushtet e financimit po shtrëngohen teksa politika monetare globale po përpiqet ta zbusë goditjen prej inflacionit. "Teksa gjysma e parë e vitit 2022 rezultoi me rritje relativisht solide, tanimë është e qartë se

rajonin e pret një stuhi tjetër", ka pohuar Sanja Madzarevic-Sujster, ekonomiste e lartë e Bankës Botërore dhe një prej autorëve kryesorë të raportit. "Goditjet e kombinuara kanë ndikim të rëndë në perspektivën e rajonit. Kushtet më të shtrënguara globale për financim, ngadalësimi i kërkesës së brendshme dhe të jashtme, si dhe dobësimi i besimit të bizneseve dhe konsumatorëve, me siguri që do të ndikojnë në sektorin financiar të rajonit", ka theksuar ajo.

Veç shtrëngimit të kushteve të financimit, raporti vë në pah se ende ekziston risku që Covid-19 të shpërthejë sërish gjatë dimrit, ndërsa zinxhirët globalë të furnizimit vazhdojnë të jenë në gjendje stresi. "Në plan afatshkurtër, për t'i minimizuar rreziqet fiskale, qeveritë duhet t'i kenë prioritet politik që mbështesim më të cenuarit, duke u siguruar që masat janë të përkohshme dhe prekin ata që kanë më së shumti nevojë", ka thënë Christos Kostopoulos, krye-ekonomist i Bankës

Botërore dhe një prej autorëve kryesorë të raportit. "Me hapësirë të kufizuar fiskale, prioritet i politikëbërësve po ashtu duhet të jenë reformat e domosdoshme që me kosto të kufizuar nxisin rritjen afatmesme", është shprehur ai. Sipas raportit, reforma të tilla do të duhej të përfshinin masa për rritjen e nivelit të konkurrencës, heqjen e barrierave për hyrjen e bizneseve të reja në treg, rritjen e mbajtjes së fitimeve dhe riinvestimit mes investitorëve të huaj, zbutjen e barrierave për pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore, përmirësimin e cilësisë së arsimit, si dhe ngritjen e standardeve të qeverisjes, përfshirë këtu edhe digjitalizimin.

Raporti shton edhe se vazhdimi i krizës është një tjetër argument i fortë për rëndësinë e përsheptimit të tranzicionit të gjelbër në rajon në mënyrë që nga hidrokarburet e paqëndrueshme të kalohet drejt prodhimit më të pastër të energjisë elektrike, si dhe modeleve më të gjelbra të prodhimit dhe konsumit.




ATK-ja pozicionohet si vend lider në raportin e PEFA-s

PRISHTINË, 24 TETOR - Në raportin e fundit të PEFA për Kosovën për vitin 2022, Administrata Tatimore është radhitur si vend lider në raport me vendet e rajonit. Ky raport rikonfirmon përparimin e ATK-së në fushat ku institucioni ka ndërmarrë reforma, që nga pozicioni 'C' sa ka qenë në vlerësimin e fundit në vitin 2016, reformat e bëra kanë siguruar tri vende më lart për ATK-në.

Përshkrimi i përgjithshëm i karakteristikave të treguesit brenda fushës së mbuluar mbulon administrimin e të gjitha llojeve të të ardhurave tatimore dhe jotatimore për qeverinë qendrore. Aty vlerësohen procedurat e përdorura për mbledhjen dhe monitorimin e të ardhurave të qeverisë qendrore. Raporti PEFA është një program partneriteti i Komisionit

Evropian, Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankës Botërore dhe Qeverisë së Francës, Luksemburgut, Norvegjisë, Republikës Slovake, Zvicrës dhe Mbretërisë së Bashkuar. Partneriteti është themeluar për të krijuar një qasje uniforme për mbledhjen e informacionit mbi performancën e menaxhimit financiar publik të vendeve.



Kush është Mihailo Podoliak, strategu kryesor i Ukrainës në luftën kundër Rosisë



© Anna Fil/DW

Nga Andrea MURATORE

Gazetar, komunikues, këshilltar politik, së fundmi edhe drejtor i marrëdhënieve midis presidencës ukrainase dhe shërbimeve sekrete. Mihailo Podoliak është një nga figurat më komplekse që qëndron në krah të presidentit ukrainas Volodimir Zelenski. I lindur në Lviv në vitin 1972, Podoliak u arsimua midis Ukrainës dhe Bjellorusisë. Ai u zhvendos në kryeqytetin bjellorus Minsk në vitin 1989 ku studioi për mjekësi. Që në moshë të re u përkushtua gazetarisë politike në vendin e sunduar nga autokrati Aleksandër Llukashenko. Ai iu bashkua gazetarëve të opozitës, duke u bërë një pikë referimi për një seri organizatash të shoqërisë civile. Gjatë viteve 1991-1992, Podoliak punoi në gazetën bjelloruse "FM-Bulevard", "Vremya", "Narodnaya Volya" dhe "Belorusskaya Delovaya Gazeta". Në vitin 2002, Podoliak dhe gazeta bjelloruse "Nasha Svoboda" u paditën në gjykatë nga Anatoli Tozik, kreu i Komitetit Shtetëror të Kontrollit të Bjellorusisë, të cilit nuk i pëlqeu fakti që gazetari e portretizoi atë si një planifikues, si ata në kohën e komunizmit dhe si një shantazhues. Gjykata e detyroi gazetarin të paguante një gjobë prej 2700 dollarësh. Gazeta e tij pagoi një

dëmshpërblim prej 54.000 dollarësh, dhe u detyrua të mbyllej. Gazetari investigativ, Pavel Zhuk, tha në atë kohë se dyshonte se padia që synonte mbylljen e gazetës ishte urdhëruar personalisht nga presidenti Llukashenko. Por Podoliak nuk e ndërpreu punën në atë sektor, dhe në vitin 2004 u emërua zv/kryeredaktor në gazetën "Vremya", që u bë gazeta e re mbështetëse e opozitës. Në mëngjesin e 21 qershorit 2004, oficerët e KGB-së bjelloruse trokitën në derën e shtëpisë së tij, e urdhëruan të paketonte me shpejtësi robat dhe e shoqëruan në stacionin hekurudhor të Minskut. Nga atje, gazetari u detyrua të merrte trenin e parë për në Odessa, duke u rikthyer me forcë në Ukrainë. Podoliak tha se ai dëbim erdhi pas artikujve të tij shumë kritikë ndaj qeverisë dhe KGB-ja e akuzoi atë për tendenciozitet, shpifje dhe destabilizimin e situatës në vend. Po ashtu atij iu hoq për 5 vite e drejta për të hyrë në Bjellorusi. Në vitin 2005, Podoliak u emërua kryeredaktor i një gazete në Kiev, "Ukrainska Gazeta". Nëntë muaj pas helmimit të kandidatit presidencial Viktor Jushçenko, gazeta botoi një artikull me titull "Darka e Fundit". Për helmimin u akuzuan njerëzit e afërt të Jushçenkos, David Zhvania dhe Jevhen Çervonenko. Podoliak u thirr për t'u marrë në pyetje nga

zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, dhe disa ekspertë të medias thanë se botimi nuk përmbushte standardet gazetareske. Paralelisht, gazetari punoi si një profesionist i pavarur dhe ekspert i marrëdhënieve me publikun. Më pas Podoliak bashkëpunoi me gazeta të ndryshme si reporter politik dhe i brendshëm për çështje të tilla si intelijenca dhe siguria kombëtare. Gazeta ukrainase "Babel" shkruan se një nga miqtë e Podoliak në vitet 2000 ishte këshilltari i atëhershëm i kreut të SBU, kundërzbulimit ukrainas, Vadim Hrib. Në mediat ukrainase kanë qarkulluan zëra se Podoliak bashkëpunoi me Hrib si specialist i marrëdhënieve me publikun. Por Babel, pretendon se bëhej fjalë më shumë për një punë agjenturore, të nisur që në vitin 2005. Më vonë Podoliak u bë kryeredaktor i faqes së internetit "Obozrevatel", të cilën ai e drejtoi që nga dhjetori 2011. Gjashtë muaj më vonë u bë këshilltar i një bashkëpunëtor të ngushtë të ish-presidentit Viktor Janukoviç, që më pas u kthye në pushtet si një udhëheqës i hapur pro-rus. Politikani në fjalë ishte deputeti i Partisë së Rajoneve Juri Ivanjushçenko. Pas Revolucionit Euromaidan të vitit 2014, Podoliak, që u largua nga "Obozrevatel" në fundin e 2013, ndryshoi qasje dhe në vitin 2015 u ofrua të

bashkëpunonte me kreun e administratës presidenciale të Petro Poroçenkos, Boris Lozhkin. Më vonë vazhdoi të punojë si këshilltar për disa politikanë në fushatat elektorale lokale dhe kombëtare, përpara se të përfundonte në rugëtimin e tij me yllin në rritje në politikën ukrainase, Volodimir Zelenski. Podoliak nuk e ka fshehur kurrë kuriozitetin e tij për ngritjen politike të ish-komediantit. Por në fillim ai ishte shumë spektik ndaj partisë së tij, Shërbëtori i Popullit, që e mori emrin e saj nga seriali televiziv që e bëri Zelenskin të famshëm në mbarë vendin. Në fillim të vitit 2019, në mesin e fushatës presidenciale, në blogjet dhe postimet e tij në Facebook, ai shkruante se "Shërbëtori i Popullit" rezultoi të ishte një tjetër grumbullim cinikësh mendjengushtë dhe arrogantë". Por pas fitores së tij, Zelenski e ftoi Podoliak të bëhej pjesë e stafit të tij. Në shkurtin e vitit 2020 ai u emërua shef i kabinetit të presidentit. Dy muaj më vonë, Podoliak u emërua në bordin e drejtorëve. Në këtë funksion ai vuri në zbatim njohuritë dhe aftësitë e tij duke i dhënë mundësi kreut të ri të shtetit të gjente konsensusin me organet e sigurisë. Këto aftësi i erdhën në ndihmë Zelenskit sidomos pas 24 shkurtit, ditës së pushtimit të Ukrainës nga Moska, kur ai u shndërrua në "zërin" kryesor të presidencës nga

njëra anë, dhe nga ana tjetër drejtues i luftës asimetrike të kryer nga agjentët ukrainas të shërbimeve sekrete, në mënyrë të pavarur nga intelijenca perëndimore. Gjatë luftës, Podoliak ka qenë një nga zërat kryesorë të Kievit në negociatat e shkurtra për paqe që u zhvilluan pa asnjë sukses me rusët. Ai dilte shpesh në media për t'i treguar botës momentet e rezistencës së fortë të Kievit; dhe punoi në prapaskenë për të organizuar operacionet e fshehta që e tronditën Rusinë, ku më i fundit ishte sulmi në Urën e Kerçit në fillim të tetorit. Në një intervistë të gjatë dhënë më 16 gusht për britaniken "The Guardian", Podoliak tha se synimi aktual i ukrainasve është "të shkaktojnë kaos midis forcave ruse", duke goditur linjat e furnizimit dhe bazat ruse në Krime. Sipas tij, nuk ka asnjë perspektivë që Rusia të negociojë seriozisht derisa të pësojë një disfatë në fushën e betejës. Kur më 24 gusht, Llukashenko e uroi në një mënyrë provokative Ukrainën për 31-vjetorin e pavarësisë, Podoliak e nxiti Zelenskin ta refuzonte deklaratën, dhe e quajti mesazhin e presidentit bjellorus si "cinik dhe të pasinqertë, duke pasur parasysh përfshirjen e madhe të Bjellorusisë në sulmin rus ndaj Ukrainë". "Il Giornale" – Bota.al

Për të ndryshuar të ardhmen tonë, duhet të ndryshojmë mënyrën se si ua mësojmë fëmijëve historinë



Nga Yuval Noah HARARI

Ne nuk mund t'i mbrojmë fëmijët nga historia. Në Ukrainë, miliona familje kanë humbur shtëpitë e tyre për shkak të luftës së nisur nga Vladimir Putin. Në Nju Delhi të Indisë, temperaturat rekord prej 50 gradë Celsius i detyruan fëmijët të qëndronin mbyllur brenda shtëpive të tyre këtë verë, duke mos pasur mundësi të studiojnë apo luajnë. Çmimet globale të ushqimeve po rriten, duke bërë që jo pak fëmijët në të gjithë botën të vuajnë pasojat e urisë. Pra është e pashmangshme që brezi i ardhshëm do të dojë të përballet me pyetjet e mëdha: Pse ka luftëra? Cili është vendi ynë në natyrë? Çfarë është paraja, dhe pse është ajo kaq shumë e rëndësishme? Shpeshherë, fëmijët i marrin këto pyetje shumë më seriozisht sesa të rriturit. Ata vënë në dyshim gjërat që të rriturit mund të bezdisen kur një fëmijë reagon me pyetjen "Pse?" pas çdo përgjigje që japin. Por zakonisht, fëmija vetëm sa po përpjet t'i gjejë fundin disa gjërave, në një mënyrë që të rriturit nuk e bëjnë më. Një gjë tjetër, ajo nga e cila s'mund t'i mbrojmë dot fëmijët është ekspozimi ndaj rrëfimeve të reeve historike. Që në moshë shumë të hershme, të rinjtë bombardohen me mite dhe informacione të gabuara, jo vetëm mbi ngjarjet aktuale, por edhe për historinë bazë të vetë njerëzimit. Pra kush jemi, nga vijmë dhe si arritëm këtu. Për shembull, në vendin tim të lindjes, Izraelin, edhe nxënësit në shkollat laike mësojnë zakonisht historinë e Kopshtit të Edenit, dhe

shohin imazhe shumëngjyrëshe të Arkës së Noes, shumë kohë përpara se të dëgjojnë për Neandertalët apo të shohin artin e shpellave të Lasko dhe Sulauesi. Dhe kjo qasje ka ndikimin e vet. Pasi është e mundur të gjurmohet një vijë e drejtpërdrejtë nga urdhri i Zotit për njerëzit tek libri i Zanafillës "popullojeni Tokën dhe nënshtrojeni atë" deri në Revolucionin Industrial dhe krizën e sotme ekologjike. Një linjë tjetër e drejtpërdrejtë e ndikimit mund të nxirret nga rrëfimet historike që mësojnë fëmijët rusë në shkollë, tek pushtimi i Ukrainës nga Putin dhe kriza globale e ushqimit që ka shkaktuar ai. Në rast se i lëmë fëmijët në mëshirën e miteve, çmësimi i këtyre ideve më vonë gjatë jetës do të jetë një detyrë e vështurë, dhe ndonjëherë e pamundur. Prandaj është jetike që ne të flasim hapur me fëmijët në lidhje me çështjet e mëdha dhe në një mënyrë të përgjegjshme, shkencore të bazuar në prova, në vend të besimit dogmatik. Kjo është një sfidë me të cilën jam përballur kohët e fundit, kur po shkruaja historinë e botës për fëmijët. Ajo që kam mësuar nga ky projekt, është fakti se adresimi i çështjeve të mëdha për fëmijët është një punë tepër delikate. Disa lëndë janë argëtuese, si eksplorimi i jetës së përditshme të gjuetarëve- mbledhësve të epokës së gurit, kur njerëzit jetonin në natyrë dhe kur fëmijët i kalonin ditët duke mësuar sesi të ngiteshin në pemë, si të gjurmonin kafshët dhe të ndiznin zjarrin. Por temat e tjera janë më sfiduese. Për shembull, analiza e asaj që

ndodhi kur Sapiensët e lashtë takuan Neandertalët, na nxit të diskutojmë se si mund të ishte jeta e një fëmije me një nënë Sapiens dhe një baba Neandertal, duke nxjerrë në pah tema të tilla si racizmi, lufta, genocidi dhe zhdukja. Është thelbësore që ne t'u flasim fëmijëve për anën e errët të historisë. Por si të shmangim paralizimin e tyre nga frika? Një parim udhëzues në këtë rast, është se ne duhet të shmangim përshkrimet në detaje të ngjarjeve të tmerrshme, derisa fëmijët të jenë mjaftueshëm të pjekur për t'i kuptuar si duhet ato. Ndaj kur duhet të flasim për katastrofa dhe padrejtësi, është më mirë të vihet theksi tek liria: pavarësisht se sa të tmerrshme janë gjërat, njerëzit zakonisht mund të bëjnë një ndryshim për mirë. Dhe ky nuk është mendim i dëshiruar, por vetë thelbi i historisë. Në fund të fundit, historia nuk është studimi i së kaluarës, ose thjesht një listë luftërash, fatkeqësish, dhe mbretërish të vdekur që sunduan mijëra vjet më parë. Historia është studimi se si ndryshojnë gjërat. Në rast se ne mendojmë se bota ka qenë gjithmonë e njëjtë, dhe se mënyra se si jetojmë sot është vetmja se si duhet jetuar, atëherë është e natyrshme të ndjehmë sikur ndryshimi është i pamundur, dhe se problemet me të cilat përballemi janë të pazgjidhshme. Pra edhe nëse gjërat janë shumë të padrejta, çfarë mund të bëjmë? Kështu është bota, i themi vetes. Por duke studiuar historinë, ne mësojmë se njerëzit nuk kanë jetuar gjithmonë si ne, dhe se bota po ndryshon gjatë gjithë kohës. Njerëzit

e bënë botën atë që është sot, dhe janë po njerëzit ata që mund ta ndryshojnë atë. Sigurisht, kjo nuk është një detyrë e lehtë, por kjo gjë ka ndodhur shumë herë në të kaluarën. Kjo është arsyeja pse historia është kaq e fuqishme. Ajo është çelësi për të ndryshuar botën. Kjo është aq e vërtetë sa që në shumë vende, qeveritë kanë frikë nga historia. Udhëheqësit i ndalojnë rrallëherë njerëzit që të mësojnë matematikë ose fizikë. Por shumë qeveri i ndalojnë njerëzit – sidomos të rinjtë – të mësojnë të paktën disa pjesë të historisë. Gjithçka kthehet pas tek ata mbretër të vdekur që sunduan mijëra vjet më parë, me duart e tyre të akullta që zgjaten nga përtej varrit për të kapur mendjet tona, dhe për të ngrirë ndryshimet. Tek e fundit, kanë qenë këta mbretër të vdekur prej kohësh që shpikën dhe përhapën histori të ndryshme mbi Perënditë, kombet, paratë dhe dashurinë, të cilat besohen nga shumë njerëz sot dhe u përmbahen. Për të fituar njëfarë lirie nga këto rrëfime dhe për t'u sjellë ndryshe, ne duhet të kuptojmë se si u krijuan dhe u përhapën ato. Përndryshe, nuk do t'i shohim kurrë ashtu siç janë: thjesht tregime. Fëmijët që pyesin "Pse?" janë një forcë e fuqishme që mund t'i shkundë deri në themele këto përralla të vjetra. Por përveçse duhet të shmangim terrorizimin e tyre, ne duhet të jemi të kujdesshëm edhe për të mos i ngarkuar të rinjtë me përgjegjësi të tona. Mëkati më i vjetër që bëjnë shpesh të rriturit, është pritshmëria që fëmijët të marrin përsipër projektet tona, dhe sidomos të zgjidhin problemet,

të cilat donim t'i zgjidhnim ne, por nuk e kemi kuptuar se si. Kur flasim me fëmijët mbi çështje të mëdha, ne duhet që herë pas here të pyesim veten pse po e bëjmë vërtet këtë. Çdo njeri në botë bart një barrë të rëndë. Kur u mësojmë historinë të rinjve, ne e bëjmë ndonjëherë këtë për të zhvendosur një pjesë të barrës sonë mbi supet e brezit të ardhshëm. Ne duam që të rinjtë të vazhdojnë të bartin me vete besimet, kujtimet, identitetet dhe konfliktet që na kanë rënduar gjatë gjithë jetës sonë. "Ja pra fëmijë, unë i çova këto gjëra deri në këtë pikë, tani është radha juaj!" Por kjo qasje është e padrejtë. Një arsye shumë më e mirë për të mësuar historinë, është të ndihmohen fëmijët të çlirohen nga të paktën një pjesë e frikës, iluzioneve dhe urrejtjeve të tyre. "I shihni këto gjëra, fëmijë? Unë jam përballur me to për vite me radhë, dhe ato e kanë bërë të mjerë jetën time. Ndaj bëni kujdes! Nuk duhet të merreni me to!" Shpresoj që historia të bëhet një mjet për të çliruar njerëzit dhe jo për t'i mbajtur ata peng të së kaluarës. Ajo duhet të jetë një mekanizëm për të krijuar marrëveshje të reja, në vend se të përjetësojnë konfliktet e vjetra. Tek e fundit, qëllimi i mësimet të historisë nuk është të kujtosh të kaluarën, por të çlirohesh prej saj.

Shënim: Libri i ri "Ne të pandalshmit: Si njerëzit e pushtuan botën" nga historiani i njohur izraelit me famë botërore, Yuval Noah Harari, ka dalë në treg më 20 tetor! "The Guardian" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**

TEL: 045/82 82 82

Bekim Zogaj emërohet asistent i gjyqtarit në ndeshjen Salzburg - Chelsea

PRISHTINË, 24 TETOR - Gjyqtari nga Kosova, Bekim Zogaj, do jetë pjesë e stafit të gjyqtarëve në ndeshjen Salzburg - Chelsea. Chelsea do të luajë në

udhëtim të Salzburgu për ndeshjen në kuadër të grupeve në Ligën e Kampionëve. Përpara kësaj sfide UEFA ka emëruar gjyqtarët e takimit,

në mesin e tyre do jetë edhe Bekim Zogaj. Zogaj do ta kryejë punën e asistent gjyqtarit së bashku me kryesorin Sandro Scharer, Stephane de Almeida, Juan

Martinez Munuera, Assessor Dudic, Fedayi San. Ndeshja në mes të Salzburgut dhe Chelsea do të zhvillohet sot (e martë), me fillim nga ora 18:45.



Endrit Krasniqi, 'Ylli i Javës' në Superligën e Kosovës

PRISHTINË, 24 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), së bashku me sponsorin e Superligës, janë duke vazhduar të japin çmimin "Ylli i Javës" pas çdo xhiroje në Albi Mall Superligë. Çmimi i më të mirit për javën e 13-të i ka takuar futbollistit të FC Prishtina, Endrit Krasniqi. Për futbollistin bardhekaltër kjo është hera e dytë që e fiton këtë çmim në këtë edicion. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga komisioni i veteranëve të futbollit, në përbërje Lulzim Rrmoku, Skender Kapra dhe Flamur Sinani. Endrit Krasniqi është vlerësuar për paraqitjen e mirë dhe për golin që e ka vulosur fitoren e Prishtinës në duel me Llapin (2:0) në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri". Çmimin "Ylli i Javës" Endrit Krasniqi ia ka dhënë Rinor

Bekteshi, menaxher për blerje dhe furnizim në "Albi Mall". Pas marrjes së çmimit, lojtari Krasniqi është shprehur i lumtur që vitrinës së tij të trofeve personale ia shtoi edhe një tjetër çmim të "Yllit të Javës". "Ky është një çmim i rëndësishëm për mua, pasi atë dëshiroj ta fitoj të gjithë futbollistët që janë pjesë e elitës. Kjo është hera e dytë gjatë këtij edicioni që shpërblehem me këtë çmim dhe shpresoj ta fitoj edhe herëve të tjera. Prishtina tashmë e ka kapur një seri pozitive të rezultateve, gjatë së cilës periudhë, përveç punës sonë të madhe, e kemi pasur përkrah edhe fatin. Uroj që të vazhdojmë me rezultate pozitive dhe dua t'i falënderoj të gjithë bashkëlojtarët dhe stafin për mbështetje!", ka theksuar Endrit Krasniqi për faqen zyrtare të FFK-së.



630 milionë euro për tri vjet, arsyeja pse Mbappe e zgjodhi PSG-në para Realit



PARIS, 24 TETOR - Tashmë është e qartë se përse Kylian Mbappe vendosi të qëndrojë në Paris Saint-Germain (PSG), duke hequr dorë përfundimisht nga Real Madridi. Sulmuesi francez ishte pranë kalimit në "Santiago Bernabeu", por e kishte ndryshuar vendimin në momentet e fundit. Mediet franceze kanë raportuar se kampioni i botës me Francën kishte arsye të forta për të qëndruar në "Parkun e Princave" jo për shkak të klubit më të madh apo të mundësive për të fituar më shumë trofe të rëndësishëm, por për shkak të parave dhe ofertës stratosferike të sheikëve arabë. Mediumi francez "Le Parisien" i ka zbuluar përfitimet e kontratës

trevjeçare të ish-futbollistit të Monacos me parisienët. 23-vjeçari do ta ketë një rrogë bazë prej 72 milionë eurosh në vit. Më pas, bonusi për nënshkrimin e kontratës është vendosur në shumën prej 180 milionë eurosh, të cilat do të paguhet në tri rata. Një bonus besnikërie në rritje do t'i paguhet pas çdo mbylljeje të afatit kalimtar të verës, duke filluar nga 70 milionë euro, për t'u rritur pas një viti në 80 milionë dhe më pas në 90 milionë euro, nëse Mbappe e konsideron mundësinë që të qëndrojë për një sezon tjetër në Paris. Dhe e gjithë kjo e arrin një shifër totale mahnitëse prej 630 milionë eurosh. Të gjithë e dinë tashmë arsyen e qëndrimit të Mbappes në Francë.


Ten Hag kërkon shitjen e Ronaldos në janar

MANCHESTER, 24 TETOR - Trajneri i Manchester Unitedit, Erik Ten Hag, ka kërkuar shitjen e Cristiano Ronaldos. Sipas raportimit nga "The Mirror",

trajneri i "Djave të kuq" do të jetë i lumtur nëse Ronaldo largohet në afatin kalimtar të dimrit. Ronaldo është duke kaluar në një periudhë aspak të mirë këtë

sezon, duke u përjashtuar edhe për ndeshje në kuadër të ligës. E sjellja e tij po ndikon që drejtuesit e klubit të kërkojnë ekip për të në merkaton e

janarit. Kujtojmë që ylli portugez kërkoj largimin nga "Old Trafford" në afatin e verës, por asnjë ekip nuk ishte i gatshëm t'i marrë shërbimet e tij.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Thai Massage” L.L.C. me pronar Chintana Siripreedanukul Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810831025 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Thai Massage” L.L.C. Chintana Siripreedanukul, Pristine donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811463231, Mitrovicë ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Thai Massage” L.L.C. Chintana Siripreedanukul, Pristiene, has come to the decision to quit its business: 811463231, Mitrovicë the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Kutrilin&Kraja” L.L.C. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811292359 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kutrilin&Kraja” L.L.C. Pristine donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811292359 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Kutrilin&Kraja” L.L.C. Pristine, has come to the decision to quit its business: 811292359 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shyhrete Kadriu shpall të humbur INDEX-in, e Fakultetit FSI-Prishtinë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales